



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE
MINISTRI

AR 14751 mot

URDHËR

Nr. 330 datë, 05/08/2009

PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË
FEDERATËS SHQIPTARE TË BASKETBOLLIT

Në vijim të kërkesës së Federatës Shqiptare të Basketbollit Nr. 286, datë 30.12.2008 "Dergohet për miratim Statuti i Federatës Shqiptare të Basketbollit" si dhe në mbështetje të paragrafit 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, nenit 14, ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin" i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit, nr.200, datë 28.03.2007 "Për Miratimin e Statutit Tip të Federatës Shqiptare" të ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Federatës Shqiptare të Basketbollit (FSHB) bashklidhur këtij Urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Sportit për njoftimin e këtij Urdhëri.
3. Ngarkohet Federata Shqiptare e Basketbollit (FSHB) për të kryer rregjistrimin në Gjykatë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

